

VENDIM
Nr.571, datë 3.8.2011

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NDËRMJET PROGRAMEVE, BRENDA
BUXHETIT TË VITIT 2011, MIRATUAR PËR MINISTRINË E TURIZMIT,
KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve ndërmjet programeve, në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si më poshtë vijon:

a) Në programin e trashëgimisë kulturore, për vitin 2011, të pakësohet fondi me vlerë 2 159 446 (dy milionë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e dyzet e gjashtë) lekë, në zërin “Paga” dhe fondi me vlerë 1 589 674 (një milion e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë, në zërin “Sigurime shoqërore”.

b) Në programin e artit dhe kulturës, për vitin 2011, të shtohet fondi me vlerë 2 159 446 (dy milionë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e dyzet e gjashtë) lekë, në zërin “Paga” dhe fondi me vlerë 1 589 674 (një milion e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë, në zërin “Sigurime shoqërore”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha